



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

TË MËSOJMË PËR PARANË



FLETORË
PUNË



Emri dhe mbiemri

Emri i shkollës

Klasa


LIBRI IM PËR
EDUKIM FINANCIAR



Përshëndetje,
Unë jam Paraja dhe tani
do ju mësoj shumë gjëra
për mua...

...unë kam dy
forma...

Metalike



Letër /
Kartëmonedha



Aktiviteti numër 1



Numëro dhe pastaj shkruaj shumën e parave të vendosura njëra afër tjetrës!



ÇKA ËSHTË PARAJA, NGA VJEN DHE PËR ÇKA PËRDORET?

Paraja është mjet këmbimi.
Paratë përdoren për të plotësuar nevojat dhe dëshirat tona.

Paraja fitohet duke punuar. Duke përzgjedhur profesionin që neve na pelqen dhe kemi talent, ne mund të fitojmë para.

Janë profesione të ndryshme që ne mund të zgjedhim p.sh ekonomist, mjek, inxhinier, mësues, bujk, jurist, pilot, shofer, dentist, përkthyes, gazetar, aktor, këngëtar/e, shkencëtar, futbollist, zjarrfikës, shkrimtar, polic, ushtar, astronaut, etj.



Nevoja:

Gjërat bazë të cilat na nevojiten çdo ditë si për shembull buka, shtëpia, veshëmbathja etj



Dëshira:

Gjërat shtesë të cilat ne dëshirojmë t'i kemi por që nuk janë të domosdoshme dhe mund të jetojmë edhe pa to p.sh një biçikletë e re, video lojëra etj.




Aktiviteti numër 2




Shiko ilustrimet e mëposhtme dhe shëno a është **nevojë** apo **dëshirë**!



Nevojë apo dëshirë?



Nevojë apo dëshirë?



Nevojë apo dëshirë?




Nevojë apo dëshirë?




Nevojë apo dëshirë?




Nevojë apo dëshirë?




Nevojë apo dëshirë?



Nevojë apo dëshirë?



Nevojë apo dëshirë?



Nevojë apo dëshirë?

SI DUKET PARAJA LETËR - EURO?

Paratë mund të jenë në formë metalike dhe në formë të letres. Te gjitha paratë kanë vlera të ndryshme.

Për shembull kemi para të letres me vlerë 5 euro, 10 euro, 20 euro, 50 euro, 100 euro, 200 euro dhe 500 euro.

Paratë leter -Euro, kanë vlerë të njejtë në të gjitha vendet që përdoret euro si valutë.

Paraja leter dallohet për nga disa veçori. Për shembull:

MADHËSIA Paraja e letres-Euro, ka madhësi të ndryshme nga paratë tjera. Për shembull paraja në vlerë 5 euro është më e

vogël se paraja në vlerë 10 euro. Duke u rrit vlera e parasë, rritet edhe madhësia e letres prej të ciles është punuar paraja.

NGJYRË

Paraja e euros ka shtatë (7) ngjyra të ndryshme specifike duke u bazuar në ngjyrat e ylberit. Kështu:

5	10	20	50	100	200	500
5 euro ka ngjyrë të hirit pasiqë është më e përdorura	10 euro ka ngjyrë të kuqe	20 euro ka ngjyrë të kaltër	50 euro ka ngjyrë portokalli	100 euro ka ngjyrë të gjelbërt	200 euro ka ngjyrë të verdhë	500 euro është ngjyrë vjollce

ILUSTRIME

Në paranë e letres ka ilustrime të ndryshme që e veçojnë atë nga paratë tjera. Harta e Evropës, yjet e flamurit Evro-

pian dhe vlera e parasë janë vetem disa prej ilustrimeve të cilat e dallojnë paranë Euro nga të tjerat.

SHENJA TË TJERA TË SIGURISË

paraja e letres ka disa shenja të sigurisë të cilat na ndihmojnë që të dallojmë nëse një para është false apo

jo. Ngjyra e ndryshueshme, numri serik, numri me ngjyrë smeraldi janë vetem disa nga shenjat e sigurisë së parasë leter.

Aktiviteti numër 3



Shiko kartëmonedhat
dhe lidhe me shumën
e saj në të djathtë!



→ 10€



→ 50€



→ 5€



→ 20€

ÇKA ËSHTË KURSIMI?

Tani e dimë se çka është paraja, si duket, çfarë ngjyre ka dhe çfarë vlere ka.

Tani do të mësojmë që përveq shpenzimit të parasë, ne duhet edhe ta kursejmë paranë.

Është e rëndësishme që paratë që na japin prindërit t'i përdorim

për nevojat donat ditore por edhe ti ruajm ose kursejmë.

Një fjalë e urtë popullore thotë që paraja duhet të kursehet në ditët me diell për ta përdorur në ditët e vështira me shi!


Pse na nevojitet të kursejmë?

- Kursimet na ndihmojnë të kemi para për të blerë gjërat që na nevojiten por që sikur mos të kursenim ndoshta nuk do të kishim para të mjaftueshme për ta blerë.



Si mund të kursejmë?

- Nëse kursejmë çdo ditë nga pak, në fund të javës apo muajit ne do të kemi më shumë para për të blerë gjërat që na nevojiten. Për shembull, nëse ne arrijmë të kursejmë çdo ditë nga 5 apo 10 centë nga paratë që prindërit na japin për shkollë, atëherë në fund të javës do të kemi 0.70 centë të grumbulluara. Nëse vazhdojmë të kursejmë çdo javë atëherë ne do të kemi para që të blejmë gjërat që na nevojiten.



Aktiviteti numër 4



Në tabelën e mëposhtme përgatite planin tënd të kursimit!

PLANI IM I KURSIMIT:

DITËT E JAVËS

UNË DO TË KURSEJ NGA:

E HËNË

E MARTË

E MËRKURË

E ENJTE

E PREMTE

E SHTUNË

E DIEL

TOTALI:

THËNIE TË NDRYSHME RRETH PARASË DHE KURSIMEVE

Njohuritë rreth parave janë të rëndësishme. Duke arritur t'i njohim paratë, nga vijnë paratë dhe rëndësinë e parave ne mund të jetojmë më mirë dhe mund të ndihmojmë pastaj të tjerët.



WARREN BUFFET

“Mos kurse atë çfarë ngel pas shpenzimeve, por shpenzo atë çfarë ngel pas kursimeve”

ROBERT KIYOSAKI

“Mos puno për para; bëj që paraja të punojë për juve”

BENJAMIN FRANKLIN

“Një investim në njohuri paguan interesin më të mirë.”

Aktiviteti numër 5



Tani ju jeni një ekspert i njohurive rreth parave dhe kursimeve. Gjej dhe rrumbullakëso përgjigjet e sakta!

PYETJA:

PËRGJIGJA:

1. Çka është paraja?

- a) Mjet këmbimi b) Mjet transporti

2. Paraja ka dy forma:

- a) Të letres dhe të metalit b) Të letres dhe të drurit

3. A është ide e mirë të fillojmë të kursejmë tani?

- a) Po b) Jo

4. Nëse kursejmë tani, a do të kemi më shumë para për të shpenzuar më vonë?

- a) Po b) Jo

5. Me paratë që kursej në arken time të kursimeve unë do të mund të blejë:

- a) Bicikleten b) Çanten c) Lojen time të preferuar d) Të gjitha më lartë



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

TË MËSOJMË PËR PARANË

LIBRI IM PËR
EDUKIM FINANCIAR

Departamenti i Komunikimit
Shoqata e Bankave të Kosovës
Rr. Lidhja e Pejës 177, Zona Industriale 10000, Prishtinë
Republika e Kosovës
+383 38 246 171
contact@bankassoc-kos.com
www.bankassoc-kos.com